The highest concerns again centre on pesticide residues (158) and food additives (146), followed by expiration date manipulation (71) and “all risks” (71). Concerns about contamination or storage problems are comparatively lower. This confirms a pattern: respondents are more worried about systemic or chemical hazards than about household-level handling risks.

The main implication is that awareness campaigns should not only inform about risks but also strengthen procedural knowledge (how to report, how to verify safety) and practical self-efficacy. Increasing confidence in actionable prevention appears essential.

Sources of information and trust to institutions


Television is the dominant source of information (374), followed by the internet (188), while official institutional channels such as the National Food Authority are cited far less (31).

This presents that mass media, rather than regulatory institutions, shapes food safety awareness. Institutional communication appears underutilized or insufficiently visible.



Awareness of the National Food Authority Hotline:

A majority (282) are unaware of the toll-free reporting number, while 177 know about it. Very few have actually used it (36 satisfied; 13 dissatisfied). This reflects a significant communication gap. Even when mechanisms for reporting exist, they are not widely known or used, limiting citizen engagement in enforcement.



Trust is divided: 185 report high trust and 77 moderate trust, while 141 report little trust and 100 no trust. This polarized trust landscape highlights institutional legitimacy is fragile. While a substantial segment

expresses confidence, a similarly large group remains sceptical. This division may explain limited use of reporting mechanisms and reliance on informal information channels.

Key barriers include difficulty understanding information (170), language barriers (143), and lack of trust in sources (101). Only 46 report no difficulties. This highlights structural communication challenges. Information may exist, but it is not sufficiently accessible, inclusive, or trusted. Comprehensibility emerges as a central issue. More respondents are aware that Albania is aligning food safety regulations with EU standards (262) than unaware (170). Additionally, 314 believe food safety will improve after EU accession while 89 do not. This indicates moderate optimism toward regulatory reform and external oversight. Trust in European standards appears stronger than trust in current domestic systems.

The results show that food safety information is primarily obtained through television and, to a lesser extent, the internet. Official institutional channels, including the National Food Authority, are cited far less frequently. This indicates that public awareness is shaped mainly by mass media rather than direct communication from regulatory bodies.

Awareness of the National Food Authority's toll-free reporting number is low, with more respondents unaware of its existence than aware. Actual usage of the hotline is minimal. This reveals a significant gap between the availability of formal reporting mechanisms and public knowledge or engagement with them.

Respondents report multiple barriers to accessing food safety information. The most prominent challenges include difficulty understanding the information, language barriers, and limited trust in information sources. Only a small minority report no difficulties. This indicates that communication is not fully accessible or inclusive, particularly for vulnerable groups.

Regarding regulatory alignment with the European Union, more respondents are aware of ongoing harmonization efforts than unaware, and a majority believe that EU evaluation will improve food safety standards. This reflects cautious optimism and possibly stronger confidence in external regulatory frameworks.

However, trust in domestic public institutions remains divided. While a portion of respondents express high or moderate trust, a substantial number report little or no trust. This polarization presents that institutional credibility is not uniformly established.

4. FINDINGS

Food safety is strongly conditioned by socio-economic vulnerability

The study confirms that food safety behaviors among marginalized groups are deeply influenced by economic instability. High unemployment levels and reliance on social assistance shape purchasing decisions, food storage practices, and dietary quality. A significant proportion of respondents report that

access to fresh and healthy food depends on monthly income cycles, while others cannot afford it consistently.

Food safety, therefore, is not only a matter of knowledge but also of purchasing power. Financial constraints increase the likelihood of risk-compromising behaviors such as buying discounted near-expiry products, prolonged storage, and repeated reheating of food.

Market-based food access increases dependence on regulatory oversight

The majority of respondents rely on supermarkets and local markets rather than self-production. While supermarkets may operate under more regulated conditions, the continued use of informal markets and street vendors introduces variability in hygiene and storage standards.

The market dependence places significant responsibility on inspection bodies and enforcement mechanisms to ensure that vulnerable consumers are not disproportionately exposed to unsafe food environments.

Food safety knowledge is practical but limited in depth

The findings show moderate awareness of foodborne illness symptoms and basic hygiene practices, particularly handwashing and checking expiration dates. However, technical knowledge is limited. Awareness of specific pathogens is low, understanding of safe reheating practices is inconsistent, and comprehension of food labels remains partial.

Respondents tend to focus narrowly on expiration dates, with limited attention to ingredients, nutritional content, or additives. This indicates risk-avoidance behavior rather than informed consumer decision-making.

Limited procedural knowledge and low self-confidence

A significant proportion of respondents report uncertainty about how to protect themselves from foodborne illness. Many do not know how to address food safety concerns formally, and awareness of complaint mechanisms (including the National Food Authority hotline) is low.

This indicates a gap between general concern and actionable knowledge. Consumers are aware of risks but lack procedural clarity and confidence in navigating institutional systems.

Institutional trust is divided and communication barriers persist

Trust in public institutions responsible for food safety is polarized. While some respondents express confidence, a substantial segment reports low or no trust. Institutional communication channels are underutilized, with most information obtained through television and internet sources rather than official authorities.

Barriers such as difficulty understanding information, language limitations, and lack of trust further weaken engagement. Despite this, there is moderate optimism regarding alignment with European Union food safety standards.

5. RECOMMENDATIONS

The study demonstrates that among marginalized groups in Albania, food safety is closely interlinked with economic vulnerability, institutional trust, and access to understandable information. While baseline awareness exists, gaps remain in technical knowledge, procedural confidence, and engagement with regulatory systems.

Addressing these gaps requires a multidimensional approach that combines education, social protection, institutional strengthening, and inclusive communication strategies. Strengthening food safety for marginalized communities is therefore not only a public health priority but also a social equity imperative.

Integrate food safety with social protection policies

Food safety interventions should be linked with food security and social assistance programs. Educational campaigns alone are insufficient if households lack the economic capacity to implement safe practices. Support mechanisms should consider incorporating safe food handling guidance, fresh food access incentives, and practical household-level solutions.

Strengthen practical, low-cost preventive education

Training programs should focus on simple, high-impact practices that do not require additional financial burden, such as:

- Proper hand hygiene
- Safe reheating limits
- Cross-contamination prevention
- Correct refrigeration practices

Educational materials should use clear, non-technical language and visual formats accessible to individuals with varying literacy levels.

Expand food label literacy beyond expiration dates

Awareness initiatives should broaden consumer understanding of labels, including ingredients, additives, and nutritional information. Simplified explanatory campaigns, visual guides, and community-based demonstrations would enhance informed purchasing decisions.

Improve visibility and accessibility of complaint mechanisms

The National Food Authority's reporting mechanisms, including the toll-free hotline, require stronger promotion, particularly within marginalized communities. Communication should be simplified, multilingual where necessary, and disseminated through trusted local actors such as NGOs and community mediators.

Enhance institutional transparency and community engagement

To address divided trust levels, institutions should strengthen transparency in inspection outcomes and enforcement actions. Public reporting of food safety controls and visible follow-up on complaints could increase confidence in regulatory systems. Public messaging should clearly communicate that food safety is a shared responsibility among consumers, producers, retailers, and institutions. Strengthening this collective understanding may improve cooperation and accountability across the food system.

6. ANNEXES

6.1 Questionnaire

6.2 Tables and charts of collected data

REFERENCES

1. <https://www.instat.gov.al/media/gignuadh/aanj-2024.pdf>
2. <https://www.undp.org/albania/publications/albania-development-finance-assessment>
3. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-07/albania_dfa_full_report.pdf
4. <https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>
5. European Commission. (2013). Consumer protection and vulnerable consumers: report. https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/consumers_vulnerable_report_en.pdf
6. European Commission. (2019). Albania: Report on socio-economic disparities and inclusion. https://ec.europa.eu/info/index_en
7. FAO. (2016). Guiding principles for food security and nutrition needs assessments. <http://www.fao.org/3/a-i5516e.pdf>
8. Food and Agriculture Organization & World Health Organization. (2019). Food safety: what you should know. <http://www.fao.org/3/ca3562en/CA3562EN.pdf>
9. FAO. (2019). Albania — Country Brief. <http://www.fao.org/3/ca-briefs/en/>
10. FAO, IFAD, UNICEF, WFP & WHO. (2020). The State of Food Security and Nutrition in the World 2020. <http://www.fao.org/3/ca9692en/online/ca9692en.html>
11. Grace, D. (2015). Food safety in low- and middle-income countries. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 12(9), 10490–10507. <https://doi.org/10.3390/ijerph120910490>
12. Headey, D., & Ecker, O. (2013). Rethinking the measurement of food security: from first principles to best practice. *Food Security*, 5, 327–343. <https://doi.org/10.1007/s12571-013-0253-0>
13. ILO. (2018). Women and men in the informal economy: A statistical picture — Albania context. https://www.ilo.org/global/publications/books/WCMS_626831/lang--en/index.htm
14. INSTAT Albania. (2020). Regional Statistics and Labour Market Data. <https://instat.gov.al>
15. Kireziova, K., et al. (2015). Food safety in low-resource settings: refrigeration, storage, and post-harvest practices. *Food Control*, 50, 557–563. <https://doi.org/10.1016/j.foodcont.2014.09.022>
16. Law on Consumer Protection: <https://ishmt.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/Ligji-9902-date-17.04.2008-i-ndryshuar-version-i-konsoliduar-2018.pdf>
17. Food Law No. 9863, as amended: <https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/ligj-2008-01-28-9863-PER-USHQIMIN-I-perditesuar.pdf>
18. Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2018). Consumer Policy Toolkit. <https://www.oecd.org/competition/consumer/consumer-policy-toolkit-2018.pdf>
19. Smith, A., & Haddad, L. (2015). Reducing child undernutrition: past drivers and priorities for the post-MDG era. *World Development*, 68, 180–204. <https://doi.org/10.1016/j.worlddev.2014.11.014>
20. UNDP Albania. (2020). Human Development Report — Albania. <https://www.al.undp.org>
21. World Bank. (2018). Diagnostic tools for inclusive food system policy. <https://www.worldbank.org/en/topic/food-security>
22. World Bank Albania. (2021). Albania Economic Update: <https://www.worldbank.org/en/country/albania/publication/economic-update>
23. World Health Organization. (2015). WHO estimates of the global burden of foodborne diseases: https://www.who.int/foodsafety/publications/foodborne_disease/fergreport/en/

24. World Bank. (2017). Protecting consumers in the digital and global marketplace. In Global Consumer Protection. World Bank Group. <https://documents.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/103201510365>



Funded by
the European Union



PROJEKTI: "SAFE – Mbështetje për Edukimin Ushqimor në Shqipëri"

Vlerësimi i nevojave të komunitetit për grupet e marginalizuara

Autore: Tana Kika

Shënim: Ky studim është kryer në kuadër të projektit “SAFE - Mbështetje për edukimin mbi sigurinë ushqimore në Shqipëri”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Qendra për Ekselencë Destiny (DCE) dhe Qendra TEAM. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
1.1 Sfondi dhe konteksti	3
1.2 Rëndësia e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.....	5
1.3 Korniza Institucionale dhe Rregullatore për Sigurinë Ushqimore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit në Shqipëri	6
2. Qëllimi dhe metodologjia	8
2.1 Qëllimi i studimit	8
2.2 Metodologjia	8
2.3 Konsiderata etike	9
3. Analiza e të dhënave të sondazhit	10
4. Gjetjet	21
5. Rekomandime	22
6. Shtojca	22

1. Hyrje

1.1 Situata aktuale dhe konteksti

Në Shqipëri, grupet e marginalizuara dhe të cënueshme karakterizohen nga rreziqe të ndërthurura që lidhen me **varfërinë, të ardhurat e ulëta dhe të paqëndrueshme, aksesin e kufizuar në shërbime, barrierat që lidhen me aftësinë e kufizuar, përjashtimin e pakicave etnike, pabarazinë gjinore dhe pabarazitë rajonale**. Këto dimensionet shpesh përforcojnë njëra-tjetrën, duke krijuar cënueshmëri të vazhdueshme për grupe të caktuara dhe duke rritur mundësinë e privimit, përfshirë pasigurinë ushqimore dhe praktikën e kompromentuar të sigurisë ushqimore.

Të dhënat kombëtare¹ tregojnë në mënyrë të qëndrueshme se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë përjeton cënueshmëri ekonomike. Në vitin 2024, **norma e rrezikut të varfërisë** (të ardhurat nën pragun kombëtar) ishte 19.2%, pak më e përmirësuar krahasuar me vitin 2023. **Pragu i rrezikut të varfërisë** për një familje njëpersonëshe u vlerësua në **324,336 ALL në vitin 2024** (nga 262,325 ALL në 2023), duke pasqyruar rritjen e kostos së jetesës dhe ndryshimet në strukturën e shpenzimeve familjare. Pjesa e individëve **në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social (AROE)** u raportua në **40.5% në vitin 2024** (një tregues i përbërë që përfshin rrezikun e varfërisë, privimin e rëndë material/social, ose intensitetin shumë të ulët të punës). Ndërkohë, sipas gjetjeve të INSTAT për vitin 2023, norma e rrezikut të varfërisë ishte 19.7%, duke dëshmuar vazhdimësinë e cënueshmërisë ekonomike edhe përpara përditësimit më të fundit për vitin 2024.

Mbrojtja sociale shërben si një mekanizëm kyç për përballimin e vështirësive nga familjet vulnerabël; megjithatë, grupet përfituese mbeten të ekspozuara në mënyrë strukturore ndaj privimit material. Një Vlerësim i Financimit për Zhvillim i UNDP-së² vëren se **Ndihma Ekonomike (NE)** mbështeti **64,000 familje në vitin 2022**, që përfaqëson rreth **224,000 përfitues individualë**, dhe se nivelet e përfitimeve të NE u rritën gjatë periudhës 2018–2022³. Programi i Reformës Ekonomike (ERP) i Shqipërisë gjithashtu përmend mbështetjen për **rreth 50,000 familje** në kuadër të skemës së ndihmës ekonomike.

Komunitetet rome dhe egjiptiane dokumentohen gjerësisht si ndër grupet më të përjashtuara, duke u përballur me pengesa në arsim, punësim, strehim dhe akses në shërbime. Profili i INSTAT-it, i bazuar në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011, tregon sfida që lidhen me **vetëidentifikimin** dhe **nënnumërimin**, ku regjistrimi evidentoi 11,669 persona (8,301 romë dhe 3,668 egjiptianë), ndërsa vlerësime të tjera të cituara në të njëjtin raport janë shumë më të larta (p.sh., **115,000** nga Këshilli i Evropës; **13,000** nga një sondazh i UNICEF-it).

Personat me aftësi të kufizuara shpesh përjetojnë pengesa në punësim, në aksesin ndaj shërbimeve dhe pjesëmarrjen sociale, duke rritur cënueshmërinë ndaj varfërisë dhe varësisë. Një prezantim i INSTAT-it mbi aftësitë e kufizuara raporton se **6.2% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç** ka të paktën një lloj aftësie

¹ <https://www.instat.gov.al/media/gignuadh/aanj-2024.pdf>

² <https://www.undp.org/albania/publications/albania-development-finance-assessment>

³ https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-07/albania_dfa_full_report.pdf

të kufizuar, ku gratë kanë rezultuar paksa më të prekura se burrat. INSTAT⁴ gjithashtu vëren se personat me aftësi të kufizuara përfshihen në skemat e mbrojtjes sociale, duke reflektuar rëndësinë e përfitimeve dhe sistemeve të mbështetjes që lidhen me aftësitë e kufizuara. Megjithatë, përfshirja në skemat e mbrojtjes sociale e kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara nuk do të thotë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara janë të përfshirë plotësisht, kryesisht për shkak të vështirësive në përmbushjen e kriterëve të dokumentacionit kualifikues, barrierave administrative, mungesës së përfshirjes, boshllëqeve gjeografike dhe të shërbimeve, si dhe problemeve me të dhënat dhe identifikimin: nën-regjistrimi dhe të dhënat e dobëta mbi aftësitë e kufizuara çojnë në numërim të pamjaftueshëm të përfituesve. Megjithatë, vërehet një rritje të lehtë të përgjithshme të numrit total të personave me aftësi të kufizuara që mbështeten nga viti 2022 në 2024, me rreth 3,000 përfitues më shumë.

Mosstabiliteti në punësim është një rrugë kryesore drejt varfërisë dhe pasigurisë ushqimore, veçanërisht **midis të rinjve dhe grave**. Anketa tremujore mbi Forcën e Punës së INSTAT-it (Tremujori i 2-të 2025) raporton një normë zyrtare papunësie prej **7.5% për burrat dhe 9.8% për gratë**, duke treguar një hendek gjinior. INSTAT gjithashtu vëren se **papunësia e të rinjve (15–29 vjeç) është 15.1% në tremujorin e dytë të vitit 2025, dhe 15% në raportin e tremujorit të tretë të vitit 2025**. Në veçanti, siguria ushqimore dhe sigurimi i ushqimit përbëjnë shtyllat themelore të mirëqenies sociale dhe shëndetit publik në Shqipëri, veçanërisht për popullatat e marginalizuara dhe të cënueshme. Ndërsa treguesit ekonomikë kombëtarë kanë treguar përmirësim gradual për vitet e fundit, pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave, stabiliteti i punësimit dhe qasja në mbrojtje sociale vazhdojnë të ekspozojnë segmente të konsiderueshme të popullsisë ndaj pasigurisë ushqimore⁵.

Pasiguria ushqimore nuk lidhet vetëm me mungesën e disponueshmërisë së ushqimit, por gjithashtu me aksesin ekonomik, përshtatshmërinë ushqyese, cilësinë e ushqimit dhe standardet e sigurisë ushqimore. Për familjet me të ardhura të ulëta, punësimi i paqëndrueshëm, puna informale dhe rritja e kostos të jetesës reduktojnë ndjeshëm fuqinë blerëse, duke çuar shpesh në cenim të diversitetit ushqimor dhe në varësi nga produktet ushqimore me kosto të ulët, por me vlerë ushqyese të pamjaftueshme. Në zonat rurale dhe periferike, infrastruktura e kufizuar dhe aksesit i ulët në tregje mund të kufizojnë më tej disponueshmërinë dhe shumëllojshmërinë e ushqimit.

Grupet e marginalizuara, përfshirë dhe familjet me të ardhura të ulëta, të papunët, familjet me një prind të vetëm, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit që jetojnë vetëm dhe pakicat etnike, përballen me rreziqe të pabarabarta lidhur me pasigurinë ushqimore. Këto rreziqe shpesh intensifikohen nga barrierat strukturore si qasja e kufizuar në ndihmën sociale, mekanizmat e pamjaftueshëm të mbështetjes vendore dhe informacioni i pamjaftueshëm mbi standardet e sigurisë ushqimore⁶.

Siguria ushqimore përbën gjithashtu një shqetësim në aspekt të shëndetit publik. Ndërgjegjësimi i kufizuar për kushtet e ruajtjes së duhur të ushqimit, praktikatat higjienike dhe standardet e konsumit të sigurt, duke shtuar dhe aksesin e kufizuar në produkte ushqimore të kontrolluara për cilësinë e tyre, mund të rrisin

⁴ <https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>

⁵ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099502310122217701/pdf/IDU0dfc794bb0b54604f250ada505455fc55a4c7.pdf>

⁶ <https://www.worldbank.org/en/country/albania/publication/economic-update>; https://ec.europa.eu/info/index_en

ekspozimin ndaj rreziqeve shëndetësore. Në familjet ekonomikisht të pambrojtura, kufizimet financiare shpesh ndikojnë në kompromise midis sasisë dhe cilësisë së ushqimit, duke çuar në kequshqyerje, mungesa të përbërësve ushqimorë ose dhe deri në komplikacione shëndetësore⁷.

Dallimet rajonale ndikojnë edhe më tej në modelet e aksesit në ushqim. Qendrat urbane si Tirana mund të ofrojnë më shumë mundësi tregu, por gjithashtu karakterizohen nga kosto më të larta të jetesës, ndërsa zonat rurale në rajone të tilla si Dibër, Gjirokastrë, Korçë e të tjera, mund të përballen me kufizime infrastrukturore dhe në shërbime. Kuptimi i këtyre ndryshimeve rajonale është thelbësor për përshtatjen e ndërhyrjeve specifike. Duke marrë parasysh natyrën shumëdimensionale të pasigurisë ushqimore, që përfshin cënueshmërinë ekonomike, aksesin në shërbime, nivelet e ndërgjegjësimit dhe pabarazitë strukturore, është e nevojshme një vlerësim gjithëpërfshirës në nivel komuniteti. Mbledhja e të dhënave drejtpërdrejt nga popullatat e përmendura dhe të përfshira mundëson një kuptim më të qartë të shkallës dhe karakteristikave specifike të cënueshmërive lidhur me ushqimin në rajone të ndryshme.

Ky Vlerësim i Nevojave të Komunitetit synon të ofrojë njohuri të bazuara në të dhëna reale mbi sfidat e sigurisë ushqimore dhe sigurimit të ushqimit ndër grupet e marginalizuara në pesë rajone të Shqipërisë. Duke identifikuar nevojat prioritare dhe boshllëqet në shërbime, ky studim mbështet marrjen e vendimeve të informuara për autoritetet lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e zhvillimit që synojnë të forcojnë qëndrueshmërinë ushqimore dhe të promovojnë përfshirjen sociale.

1.2 Rëndësia e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit

Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit janë komponentë themelorë të shëndetit publik, barazisë sociale dhe dinjitetit njerëzor. Ndërsa siguri i ushqimit siguron aksesin në ushqim të mjaftueshëm, siguria ushqimore garanton që ky ushqim të jetë i sigurt për konsum dhe i pastër nga kontaminantët, modifikimet dhe rreziqet shëndetësore⁸. Për grupet e marginalizuara dhe ekonomikisht të ndjeshme, rëndësia e sigurisë ushqimore është veçanërisht e madhe për shkak të disavantazheve strukturore që rrisin ekspozimin e këtyre grupeve ndaj mjediseve ushqimore të pasigurta.

Familjet me të ardhura të ulëta shpesh i japin përparësi çmimit të ulët mbi cilësinë kur blejnë ushqime. Fuqia e kufizuar blerëse mund të çojë ata të mbështeten në produkte me kosto të ulët, tregjet informale, artikujt me zbritje pranë datës së skadencës, ose ushqime të ruajtur në kushte jo të duhura. Në këto rrethana, rreziku i ekspozimit ndaj sëmundjeve të transmetuara me anë të ushqimit, produkteve të kontaminuara, ose ushqimit me vlerë të pamjaftueshme ushqyese rritet ndjeshëm. Konsumatorët e marginalizuar mund të mos kenë gjithashtu akses në informacion të saktë në lidhje me etiketimin, datat e skadencës, origjinën e produktit, dhe praktikën e sigurta të trajtimit të ushqimit⁹.

Mekanizmat e mbrojtjes së konsumatorit luajnë një rol kritik në mbrojtjen e popullatave të cënueshme nga produktet e pasigurta dhe praktikën e padrejta të tregut. Megjithatë, grupet e marginalizuara shpesh

⁷ https://www.who.int/foodsafety/publications/foodborne_disease/fergreport/en/; <https://doi.org/10.3390/ijerph120910490>

⁸ https://www.who.int/foodsafety/publications/foodborne_disease/fergreport/en/; <http://www.fao.org/3/ca3562en/CA3562EN.pdf>.

⁹ <https://doi.org/10.3390/ijerph120910490>; <https://doi.org/10.1016/j.worlddev.2014.11.014>

përballen me pengesa në aksesin e mekanizmit të ankesës, raportimin e shkeljeve ose kërkimin e mbështetjes institucionale. Ndërgjegjësimi i kufizuar për të drejtat e konsumatorit, besimi i ulët institucional, izolimi gjeografik dhe kompleksiteti administrativ mund t'i pengojnë këta individë të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive. Si rezultat, produktet ushqimore të pasigurta mund të qarkullojnë në mënyrë disproporcionale në zonat me mbikëqyrje më të dobët ose kapacitet të reduktuar për mbrojtjen e konsumatorit¹⁰.

Siguria ushqimore është gjithashtu e lidhur ngushtë edhe me rezultatet e shëndetit publik. Fëmijët, të moshuarit dhe personat me sistem imunitar të komprometuar, të cilët shpesh janë më të përfaqësuar në mesin e grupeve të marginalizuara, janë veçanërisht të prekshëm nga sëmundjet të shkaktuara me anë të ushqimit. Kushtet e papërshtatshme të ruajtjes së ushqimit për shkak të banesave të mbipopulluara, furnizimit të ndërprerë me energji elektrike ose mungesës së frigoriferit rrisin më tej rreziqet shëndetësore. Në këto raste, siguria ushqimore bëhet jo vetëm një çështje rregullatore, por edhe një shqetësim për mbrojtjen sociale dhe barazinë shëndetësore¹¹.

Për më tepër, paqëndrueshmëria ekonomike intensifikon cënueshmërinë. Kur familjet përballen me papunësi, kushte pune informale ose ndihmë sociale të pamjaftueshme, ato mund të ulin ndjeshëm larmishmërinë ushqimore, duke blerë ushqime të përpunuara më të lira ose të anashkalojnë vakte të tëra. Këto strategji përballimi mund të dëmtojnë ekuilibrin ushqyes dhe shëndetin në mënyrë afatgjatë. Garantimi i sigurisë ushqimore në këtë aspekt kontribuon në thyerjen e cikleve të privimit dhe parandalon barrën financiare të mëtejshme lidhur me shëndetin mbi familjet tashmë të cënueshme¹².

Për komunitetet e marginalizuara, veçanërisht ato që përballen me diskriminim ose izolim gjeografik, sistemet efektive të mbrojtjes së konsumatorit janë thelbësore për të siguruar një trajtim dhe akses të drejtë dhe të barabartë në tregje dhe në mallra të sigurta. Prandaj forcimi i ndërgjegjësimit për të drejtat e konsumatorit, përmirësimi i zbatimit të rregulloreve dhe rritja e përgjegjshmërisë institucionale janë komponentë kritikë të zhvillimit gjithëpërfshirës¹³.

Në kontekstin e Vlerësimit të Nevojave të Komunitetit, shqyrtimi i sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit nga perspektiva e grupeve të marginalizuara ofron prova thelbësore për përgjigje të synuara politike. Identifikimi i pengesave në aksesin ndaj ushqimit të sigurt, boshllëqeve në ndërgjegjësim dhe mangësive institucionale do të mbështesë hartimin e ndërhyrjeve që promovojnë qasje të barabartë në ushqim të sigurt, të përballueshëm dhe ushqyes në të gjitha rajonet e përfshira në këtë studim.

¹⁰<https://documents.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/103201510365> ;
<https://www.oecd.org/competition/consumer/consumer-policy-toolkit-2018.pdf>

¹¹ https://www.who.int/foodsafety/publications/foodborne_disease/fergreport/en/ ;
<https://doi.org/10.1016/j.foodcont.2014.09.022>

¹² <https://doi.org/10.1007/s12571-013-0253-0> ; <http://www.fao.org/3/ca9692en/online/ca9692en.html>

¹³ https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/consumers_vulnerable_report_en.pdf

1.3 Korniza institucionale dhe rregullatore për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri

Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit në Shqipëri është e rregulluar nga një kornizë ligjore dhe institucionale e strukturuar, e përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me standardet e Bashkimit Evropian. Legjislacioni kryesor që rregullon sigurinë ushqimore në vend është **Ligji Nr. 9863 "Për Ushqimin"**, i ndryshuar, i cili vendos parimet bazë mbi sigurinë ushqimore, gjurmueshmërinë, vlerësimin e rrezikut dhe përgjegjësisë së operatorëve të biznesit ushqimor. Ligji pasqyron qasjen "nga ferma në tavolinë", duke theksuar kontrollin në të gjithë zinxhirin ushqimor, nga prodhimi dhe përpunimi deri te shpërndarja dhe shitja me pakicë.

Institucioni qendror përgjegjës për zbatimin dhe respektimin e ligjit është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU). AKU vepron në varësi të Ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe sigurinë ushqimore dhe ka detyrë inspektimin, monitorimin, menaxhimin e riskut dhe zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore në të gjithë vendin. Përgjegjësia e AKU përfshin mbikëqyrjen e operatorëve të bizneseve ushqimore, kontrollet e importit/eksportit, marrjen e mostrave për produktet ushqimore, testimin laboratorik dhe reagimin ndaj rasteve të cënimit të sigurisë ushqimore.

Në nivel vendor, inspektoratet bashkiake dhe strukturat e vetëqeverisjes vendore gjithashtu luajnë një rol në mbikëqyrjen e tregut, veçanërisht në tregjet e hapura, njësitë e vogla të shitjes me pakicë dhe mjediset e tregjeve informale. Këto mekanizma të decentralizuar janë thelbësorë për sigurimin e përputhshmërisë në nivel komuniteti. Megjithatë, pabarazitë në kapacitetin institucional, stafin, burimet njerëzore e teknike dhe frekuencën e inspektimeve mund të çojnë në zbatim të pabarabartë për të gjithë rajonet.

Përveç legjislacionit për sigurinë ushqimore, të drejtat e konsumatorit mbrohen me **Ligjin Nr. 9902 "Për Mbrojtjen e Konsumatorit"**, i cili vendos të drejtën për siguri, informacion, zgjedhje dhe dëmshpërblim. Strukturat për mbrojtjen e konsumatorit, duke përfshirë drejtoritë përgjegjëse brenda ministrive përkatëse dhe strukturat bashkiake, synojnë të mbrojnë individët nga produktet e pasigurta dhe praktikatat tregtare të padrejta. Megjithatë, grupet e cënueshme dhe të marginalizuara shpesh përballen me pengesa praktike në aksesimin e mekanizmave të ankesave, raportimin e shkeljeve ose në orientimin e procedurave administrative.

Për komunitetet e marginalizuara, efektiviteti i këtij kuadri rregullator është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Kur mekanizmat e zbatimit funksionojnë në mënyrë efektive, konsumatorët përfitojnë nga produkte më të sigurt, etiketim më i qartë dhe gjurmueshmëri e përmirësuar. Përkundrazi, në kontekste ku monitorimi është më i dobët ose tregjet informale mbizotërojnë, familjet ekonomikisht të cënueshme mund të jenë në mënyrë disproporcionale të ekspozuara ndaj produkteve ushqimore nën standard ose edhe të pasigurta.

Përforcimi i koordinimit midis Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, inspektorateve bashkiake, organeve të mbrojtjes së konsumatorit dhe shërbimeve sociale është thelbësor për t'u siguruar që masat e sigurisë ushqimore përkthehen në mbrojtje reale për popullatat e marginalizuara. Në kuadër të këtij Vlerësimi të

Nevojave të Komunitetit, analizimi i gjetjeve të ndërgjegjësimit mbi standardet e sigurisë ushqimore, besimit në institucione dhe aksesit në mekanizmat e ankimit ofron njohuri të rëndësishme se si funksionojnë në praktikë mbrojtjet rregullatore për grupet e cënueshme në të gjithë Shqipërinë.

2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

2.1 Qëllimi i studimit

Projekti "SAFE: Mbështetje për Edukimin Ushqimor në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian, zbatohet pothuajse në të gjithë Shqipërinë nga Qendra për Ekselencë Destiny dhe Qendra TEAM-Together Everyone Achieves More. Një nga rezultatet e këtij projekti është edhe përgatitja e studimi mbi: Vlerësimin e Nevojave për Grupet e Margjinalizuara në rajonet e Tiranës, Gjirokastrës, Vlorës, Shkodrës dhe Korçës.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nivelin e ndërgjegjësimit, njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve lidhur me sigurinë ushqimore në grupet e margjinalizuara në Shqipëri. Studimi synon të identifikojë hendekët në kuptueshmëri, barrierat lidhur me praktikën e sigurisë ushqimore, dhe kufizimet që pengojnë angazhimin aktiv të konsumatorit brenda sistemit të sigurisë ushqimore.

Konkretisht, vlerësimi synon të:

- Vlerësojë se si grupet e margjinalizuara perceptojnë risqet dhe përgjegjësitë mbi sigurinë ushqimore;
- Masë nivelin e njohurive të tyre lidhur mbi standardet, praktikën dhe mekanizmat e raportimit të sigurisë ushqimore;
- Identifikimin e modeleve të sjelljes që lidhen me blerjen, trajtimin dhe raportimin e rreziqeve të ushqimit;
- Kuptimin të nivelit të besimit ndaj institucioneve publike përgjegjëse për sigurinë ushqimore;
- Identifikimin e nevojave kryesore dhe sfidave me të cilat përballen komunitetet e cënueshme në aksesin për ushqim të sigurt dhe informacionit të besueshëm.

Gjetjet do të ofrojnë njohuri të bazuara në prova për të mbështetur përpjekjet për sensibilizim, për të forcuar bashkëpunimin shumë palësh dhe për të kontribuar në përmirësimin e efektivitetit të sistemit të sigurisë ushqimore të Shqipërisë sipas qasjes “Një Shëndet”. Studimi gjithashtu do të shërbejë si bazë për dialogun politik dhe marrjen e vendimeve të informuara përmes prezantimit të rezultateve në tryeza të rrumbullakëta me palët e interesuara.

2.2 Metodologjia

Ky studim është përshtatur mbi hartimin e një studimi tërësor dhe sasior me synimin për të vlerësuar njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e grupeve të margjinalizuara në Shqipëri lidhur me sigurinë ushqimore.

Qasja tërësore ka mundësuar mbledhjen e të dhënave njëherazi, duke ofruar një pikëpamje të perceptimeve, sjelljeve dhe kufizimeve aktuale që lidhen me sigurinë ushqimore në komunitetet e synuara.

Hulumtimi u krye duke përdorur një **pyetësor të strukturuar**, të zhvilluar në përputhje me objektivat e projektit SAFE dhe të udhëhequr nga strategjitë përkatëse kombëtare dhe ato të BE-së për sigurinë ushqimore. Pyetësi është hartuar për të siguruar qartësi, ndjeshmëri kulturore dhe qasje, veçanërisht duke marrë parasysh kufizimet e mundshme të shkrim-leximit brenda grupeve të marginalizuara.

Siç përcaktohet në pyetësor (bashkëngjitur këtij raporti si aneks), ai përfshin seksione që mbulojnë karakteristikat demografike, aksesin dhe sigurimin e ushqimit, njohuritë dhe ndërgjegjësimin për sigurinë ushqimore, qëndrimet dhe besimin ndaj institucioneve, si dhe arritjen deri në informim.

Grupet e synuara: Popullsia e synuar e këtij studimi përbëhet nga grupe të marginalizuara që jetojnë në qarqet e synuara të projektit në Shqipëri. Ato përfshijnë:

- Anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian;
- Gratë e papuna;
- Kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara;
- Familjet që marrin ndihmë sociale ose që klasifikohen si familje me të ardhura të ulëta.

Këto grupe janë përzgjedhur bazuar në cënueshmërinë e tyre të rritur ndaj pasigurimit të ushqimit, aksesin e kufizuar në informacion të besueshëm, disavantazhet socio-ekonomike dhe ekspozimin e mundshëm ndaj rreziqeve më të larta të sigurisë ushqimore.

Kriteret e përfshirjes për pjesëmarrje ishin:

- Personat mbi 18 vjeç
- Përkatësia ndaj njëres prej kategorive të identifikuara si të marginalizuara
- Të jetojnë në njërin prej qarqeve të targetuara (Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë)
- Dhënia e pëlqimit për të informuar dhe të qenë vullnetar për pjesëmarrje

Pjesëmarrja ishte anonime dhe konfidenciale, në përputhje me parimet etike të kërkimit dhe standardet e kërkimit për pjesëmarrje dhe të bazuar në komunitet.

Kampionimi dhe mbulimi: Numri total i **pjesëmarrësve** të anketuar është **511**, duke siguruar përfaqësim të mjaftueshëm të të gjitha kategorive të përzgjedhura të grupeve të marginalizuara dhe të zonave gjeografike. Kjo madhësi kampionimi është në përputhje me indikatorin e synuar nga projekti (500), të përcaktuar edhe në Termat e Referencës, dhe siguron besueshmëri të mjaftueshme statistikore për analizën përshkruese.

Anketa mbuloi rajonet e mëposhtme: Tirana, Gjirokastra, Vlora, Shkodra dhe Korça. Shpërndarja e të anketuarve siguroi një përfaqësim nga të gjitha rajonet e përzgjedhura dhe kategoritë e marginalizuara, duke ruajtur ekuilibrin gjinor aty ku ishte e mundur.

Duke marrë parasysh natyrën e popullsisë së synuar dhe konsideratat e qasjes në informacion, u aplikua **një qasje e kampionimit të qëllimshëm e kombinuar me kampionin e përshtatshëm**. U vendos bashkëpunim me disa OJQ dhe organizata komunitare që punojnë drejtpërdrejt me komunitetet e marginalizuara dhe kjo u konsiderua si një mekanizëm i përshtatshëm për shkak të vështirësisë së zbatimit të kampionimit të rastësishëm dhe stikt brenda popullatave të cënueshme, të cilat mund të ishin të vështira për t'u arritur. Përveç kësaj, u vendos bashkëpunim me Sektorët e Ndhmës Sociale dhe Ekonomike në Bashkitë e Tiranës dhe Gjirokastrës.

Procesi i mbledhjes së të dhënave u realizua përmes një **qasjeje të ndërthurur**, kryesisht duke përdorur pyetësorë të strukturuar të administruar elektronikisht (Google Forms) dhe, kur ishte e nevojshme, shpërndarja e mëtejshme fizike, me mbështetjen e disa OJQ lokale, përmes takimeve ballë për ballë dhe takimeve në terren me komunitetet, veçanërisht me komunitetet Rome dhe Egjiptiane, si dhe gratë e papuna. Pjesëmarrësve ju ofrua ndihmë për plotësimin e pyetësorit online, duke siguruar konfidencialitetin dhe pjesëmarrjen në mënyrë vullnetare.

2.3 Parimet etike

Ky studim u krye në përputhje të plotë me parimet etike të kërkimit, veçanërisht duke pasur parasysh përfshirjen e popullatave të cënueshme dhe atyre të marginalizuara. Pjesëmarrja ishte krejtësisht vullnetare, dhe të gjithë të anketuarit u informuan për qëllimin e studimit, natyrën e përfshirjes së tyre dhe të drejtën e tyre për të refuzuar ose tërhequr në çdo kohë pa asnjë pasojë. Për të siguruar konfidencialitetin dhe anonimitetin, nuk u mbledh asnjë informacion personal i identifikueshëm (si psh. emrat ose adresat e sakta). Përgjigjet u regjistruan në mënyrë anonime, dhe të gjitha të dhënat u ruajtën në mënyrë të sigurt dhe u përpunuar nga ekspertit për qëllime analize. Pyetësori u hartua duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të respektuese për të shmangur paragjykimin, pakënaqësitë, ose keqkuptimet, veçanërisht duke marrë parasysh barrierat e mundshme të shkrim-leximit.

